



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), dhe të nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.08.2018, miratoi këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Osman (Rizë) Breznica, Faik (Rizë) Breznica, Rexhep (Bajram) Breznica, Hysen (Murat) Breznica, Shefqet (Bajram) Breznica, Xhavit (Bajram) Breznica, Xhelal (Bajram) Breznica, Mervete (Murat) Gubetini, Rita (Ahmet) Breznica, Ron (Ahmet) Breznica, Vesa (Ahmet) Breznica dhe Arsim (Murat) Breznica.
- II. Prona e paluajtshme e Komunës që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika:
 1. Pronat e paluajtshme në pronësi të Komunës së Prishtinës, pjesën e parcelës kadastrale, nr. 2759-9, ZK Prishtinë, e evidentuar në Certifikatën e pronësisë P-71914059-02759-9, në sipërfaqe prej 67 m², me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve:
 2. Osman (Rizë) Breznica, Faik (Rizë) Breznica, Rexhep (Bajram) Breznica, Hysen (Murat) Breznica, Shefqet (Bajram) Breznica, Xhavit (Bajram) Breznica, Xhelal (Bajram) Breznica, Mervete (Murat) Gubetini, Rita (Ahmet) Breznica, Ron (Ahmet) Breznica, Vesa (Ahmet) Breznica dhe Arsim (Murat) Breznica, parcelën kadastrale nr. 10207-2, ZK Prishtinë, e evidentuar në Certifikatën e pronësisë P-71914059-10207-2, në sipërfaqe prej 67 m².
- III. Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues urban "Muhaxhirët". Kjo i shërben shfrytëzimit për qëllime të interesit publik të Komunës. Kapitali për financimin e këmbimit është siguruar.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelës kadastrale që do të këmbëhet.

- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë shkresat e lëndës.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-195023/18, më 09.08.2018

KRYESUESI I KUVENDIT

Agim Kuleta

